

SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

Tabela .1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Inter vista	Fillimi	Mbarimi
	Specialist teknike/Ciceron dhe Përgjegjës Material	Rep.6004	Tiranë	6-muaj	Po	Po	19.03.2019	03.04.2019

Formulari nr. 1

1.Pozicioni i punës:	Specialist Teknike/Ciceron dhe Përgjegjës Material, në Seksionin e Ekspozimit të Objekteve
2. Kodi i pozicionit:	
3. Reparti/Institucioni:	Reparti Ushtarak nr.6004, Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeu i FA
4. Vendi:	Tiranë
5. Paga:	VKM nr.187, datë 08.03.2017
6. Lloji i kontratës së punës:	6 - muaj
7. Data e fillimit të aplikimit:	19.03.2019
8. Data e mbylljes së aplikimit:	03.04.2019
9. Mënyra e aplikimit:	<p>Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes në adresën www.mod.gov.al. Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës, do t'i dërgohet Njësisë së Personelit të Strukturës që është e interesuar për rekrutimin, brenda afatit të caktuar, në zarf, dorazi ose në rrugë postare në adresën (adresa postare e repartit/strukturës përkatëse): Psh.</p> <p><i>Drejtorisë së Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve</i></p> <p><i>Ministria e Mbrojtjes</i></p> <p><i>Rruga e Dibrës</i></p> <p><i>Tiranë</i></p>

10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e arsimit të lartë sëbashku me listën e notave të noterizuar
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjeko-ligjor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë; dhe 9x12, 2 copë.
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV).
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike [www. mod.gov.al](http://www.mod.gov.al). (*linku: Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë të dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

Grada/Titulli: Specialist Teknike/Ciceron dhe Përgjegjës Material, në Seksionin e Ekspozimit të Objekteve

- a. Arsimi : Arsim i lartë (civil)
- b. Kualifikimi: I lartë
- c. Trajnimi: Trajnim në fushën e kërkuar
- d. Eksperienca në Punë: Të ketë eksperienca të mëparshme në fushën e kërkuar.
- e. Gjuha e huaj: Anglisht (e preferuar)
- f. Kërkesa të tjera specifike:
- g. Niveli i certifikatës së sigurisë: N/A

a. Përshkrimi i punës:

b. Detyrat kryesore:

c. Punon vazhdimisht për njohjen në detaje të të dhënave dhe prezantimin e objekteve brenda dhe jashtë godinës së muzeut të FA-së. Prezanton saktë e me kulturë objektet e ekspozuara brenda dhe jashtë godinës së Muzeut të FA-së.

d. Përgjegjësitë:

- Monitoron vizitorët në muzeun e FA-së dhe i evidenton ata në librin e hapur për këtë qëllim.
- Merr pjesë në të gjitha aktivitetet që zhvillohen në muzeun e FA-së.

13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Njësia e Burimeve Njerëzore në MM, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e personelit verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcaktonë kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotëojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurrimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 40 (dyzetë), të cilat ndahen:

- a. Jetëshkrimi 5 pikë
- b. Arsimimi/Kualifikimi deri në 15 pikë,
- c. Trajnimi deri 5 pikë
- d. Eksperienca në punë deri 15 pikë.

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin e jetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.